



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

KPPP.nr.1007/22

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e shkallës së parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Gent Bekeri, në çështjen përmbartimore të kreditorit “NTG Blendi”, me NRB:, me seli në Prishtinë, rruga “...” nr.13, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokat A. D. nga Prishtina, kundër debitorit “Komuna e Prishtinës”, të cilin e përfaqëson sipas autorizimit Avokatura Istrefi, me seli në Prishtinë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.66/21 të datës 19.03.2021, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku, me seli në Prishtinë, jashtë seancës, me datë 14.11.2023, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Komuna e Prishtinës”, ashtu që ANULOHET pjesërisht Urdhri Përmbartimor P.nr.66/21 të datës 19.03.2021, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku, për pjesën e detyrimit në shumën prej 891.80 €.
- II. REFUZOHET pjesërisht prapësimi i debitorit “Komuna e Prishtinës”., ashtu që MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit Përmbartimor P.nr.66/21 të datës 19.03.2021, të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku, për pjesën e detyrimit në shumën prej 10,195.60 €.
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit “NTG Blendi”, ndaj debitorit “Komuna e Prishtinës” sipas urdhrin P.nr.66/21 të datës 19.03.2021, për pjesën e detyrimit në shumën prej 891.80 €.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar Urdhrin Përmbartimor P.nr.66/21 të datës 19.03.2021, me të cilin ka lejuar përmbartimin, në bazë të dokumenteve të besueshme – Fatura Nr. 2112-210-001-18, Nr. 2113-210-001-18, Nr. 1215-210-001-18, Nr. 1117-210-001-18, Nr. 2173-210-001-18, Nr. 2114-210-001-18, Nr. 2506-210-001-19,

Nr. 663-210-001-19, Nr. 2511-210-001-19, Nr. 698-210-001-19, Nr. 2509-210-001-19, Nr. 62-210-001-19, Nr. 2556-210-001-18, Nr. 286-210-001-18, Nr. 2115-210-001-18, Nr. 2168-210-001-18, Nr. 769-210-001-18, Nr. 2111-210-001-18, Nr. 4175-210-001-18, Nr. 2172-210-001-18, Nr. 620-210-001-18, Nr. 2235-210-001-19, Nr. 2402-210-001-19, Nr. 1682-210-001-18, Nr. 3836-210-001-18, Nr. 2169-210-001-18, Nr. 591-210-001-18, Nr. 1898-210-001-19, Nr. 3837-210-001-18, Nr. 2167-210-001-18, Nr. 1679-210-001-18, Nr. 190-210-001-18, Nr. 1784-210-001-19, Nr. 3840-210-001-18, Nr. 2166-210-001-18, Nr. 1642-210-001-18, Nr. 1169-210-001-19, Nr. 1622-210-001-19, Nr. 3838-210-001-18, Nr. 2165-210-001-18, Nr. 1639-210-001-18, Nr. 3754-210-001-18, Nr. 2164-210-001-18, Nr. 1637-210-001-18, Nr. 3554-210-001-19, Nr. 1543-210-001-19, Nr. 3054-210-001-19, Nr. 1542-210-001-19, Nr. 2780-210-001-19, Nr. 1377-210-001-19, Nr. 3660-210-001-18, Nr. 2162-210-001-18, Nr. 1629-210-001-18, Nr. 3653-210-001-18, Nr. 2163-210-001-185, Nr. 1635-210-001-18, Nr. 2768-210-001-19, Nr. 1372-210-001-19, Nr. 3418-210-001-18, Nr. 2161-210-001-18, Nr. 1636-210-001-18, Nr. 2552-210-001-19, Nr. 1260-210-001-19, Nr. 3405-210-001-18, Nr. 2160-210-001-18, Nr. 1606-210-001-18, Nr. 2521-210-001-19, Nr. 1328-210-001-19, Nr. 3095-210-001-18, Nr. 2159-210-001-18, Nr. 1435-210-001-18, Nr. 2520-210-001-19, Nr. 1081-210-001-19, Nr. 2966-210-001-18, Nr. 2156-210-001-18, Nr. 1218-210-001-18, Nr. 2513-210-001-19, Nr. 815-210-001-19, Nr. 3080-210-001-18, Nr. 2157-210-001-18, Nr. 1427-210-001-18, Nr. 2512-210-001-19, Nr. 356-210-001-19, Nr. 2615-210-001-18, Nr. 2155-210-001-18, Nr. 2154-210-001-18, Nr. 2153-210-001-18, Nr. 2152-210-001-18, Nr. 2140-210-001-18, Nr. 2116-210-001-18, Nr. 2151-210-001-18, Nr. 2119-210-001-18, Nr. 2149-210-001-18, Nr. 2120-210-001-18, Nr. 2123-210-001-18, Nr. 2147-210-001-18, Nr. 2121-210-001-18, Nr. 2122-210-001-18, Nr. 2124-210-001-18, Nr. 2125-210-001-18, Nr. 2127-210-001-18, Nr. 2126-210-001-18, Nr. 2128-210-001-18, Nr. 2131-210-001-18, Nr. 2132-210-001-18, Nr. 2134-210-001-18, Nr. 2139-210-001-18, Nr. 2133-210-001-18, Nr. 2136-210-001-18, Nr. 2137-210-001-18, Nr. 2148-210-001-18, Nr. 2145-210-001-18, Nr. 2129-210-001-18, Nr. 2130-210-001-18, Nr. 2138-210-001-18, Nr. 2135-210-001-18, ku e ka urdhëruar debitorin që në afat prej 7 ditësh nga dita e këtij urdhri, t'ia paguaj borxhin total kreditorit në shumë prej 11,087.40 €, me kamatë ligjore prej 8%, nga data kur ka qenë i obliguar deri në pagesën definitive, shpenzimet për përpilimin e propozimit nga avokati si dhe shpenzimet e procedurës përmbarimore në pajtim me UA-MD-së nr.06/2014 dhe të gjitha shpenzimet që do dalin gjatë procesit, nën kërcënim të përmbarimit me dhunë.

Kundër urdhrin për lejimin e përmbarimit, brenda afatit ligjor debitori ka paraqitur prapësim në të cilin ka deklaruar se dokumentet në bazë të cilave është marr urdhri përmbarues nuk kanë tipare të përmbarueshmërisë. Tutje ka shtuar se disa fatura janë të parashkruara ndërsa tjerat mbeten kontestuese për faktin se janë të njëanshme. Në vazhdim ka deklaruar se nuk është përfillur Rregulla Financiare Nr.01/2013/MF rreth shpenzimit të parasë publike si dhe nuk është zbatuar Ligji për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar. Andaj i ka propozuar Gjykatës ta aprovoj në tërësi prapësimin si të bazuar, shfuqizoj urdhrin përmbarimor si dhe të obligohet kreditori që t'i mbuloj shpenzimet e procedurës përmbarimore, përfshirë edhe shpërblimin e avokatit për përpilimin e prapësimin.

Kreditore, në afatin e paraparë ligjor ka parashtruar përgjigje në prapësim, ndër të tjera ka theksuar se prapësimi nuk i përmbush kushtet e parapara sipas LPP-së. Më tej ka deklaruar se faturat e bashkangjitura në propozim i përmbajnë të gjitha elementet e nevojshme, andaj debitori prapësimin e ka paraqitur me qëllim që vetëm ta prolongoj procedurën përmbarimore. Duke u bazuar në të lartcekurat i ka propozuar Gjykatës ta refuzoj prapësimin si të pa bazuar, urdhri përmbarimor të mbetet në fuqi si dhe të obligohet debitori që t'i mbuloj shpenzimet e procedurës përfshirë shpërblimin e avokatit për përpilimin e përgjigjes në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, kundërshtimeve të kreditorit nga përgjigjja në prapësim, si dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se *“Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm”*, ndërsa me neni 29 par. 3 të LPP-së, përcaktohet se *“Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditore dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shumata dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar “*. Me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se *“Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t'i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.”*, ndërsa sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës gjeti se Urdhri përmbartimor P.nr.66/21 i datës 19.03.2021, duhet të anulohet pjesërisht për borxhin e kërkuar nga kreditori sipas faturës Nr. 2512-210-001-19, Nr. 2513-210-001-19, Nr. 2520-210-001-19, Nr. 2521-210-001-19, Nr. 2768-210-001-19, Nr. 1542-210-001-19, Nr. 2167-210-001-18, Nr. 2402-210-001-19, Nr. 2509-210-001-19, Nr. 2511-210-001-19, Nr. 2506-210-001-19, Nr. 2512-210-001-19 për shkak se këto fatura nuk i plotësojnë kushtet e parapara me nenin 29 dhe nenin 37 të LPP –së.

Gjykata duke u bazuar në të lartcekurat gjeti se dokumenti - fatura shumë prej 516.80 € në bazë të cilës është lejuar propozimi për përmbartim nuk i plotëson kushtet ligjore për të qenë dokument i besueshëm, për faktin se fatura në rastin konkret është lëshuar në mënyrë të njëanshme nga ana e kreditorit dhe nuk është pranuar nga debitori, përkatësisht e njëjta nuk përmban nënshkrimin e pranuesit - debitorit dhe nuk ka dëshmi se e njëjta është pranuar nga debitori, dhe si të tilla nuk janë të përshtatshme për përmbartim.

Ndërsa duke vlerësuar pretendimet e debitorit lidhur me afatet e parashkrimit, Gjykata pas vlerësimit të faturave dhe duke iu referuar dispozitave të nenit 355 paragrafi 1, dhe paragrafi 2 të LMD-së (Ligji Nr.04/L-077) ka ardhur në përfundim se kërkesa e kreditorit pjesërisht është parashkruar.

Me dispozitën e nenit 355 paragrafi 1 të LMD-së përcaktohet se *“1. Kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve të bëra lidhur me këto kontrata, parashkruhen për tri (3) vite. Ndërsa me paragrafin 2 të njëjtit nen përcaktohet se: “Parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer”.*

Në rastin konkret duke llogaritur afatin e arritjes për pagesë të secilës kërkesë veç e veç, rezulton se kërkesat e kreditorit për faturat Nr. 190-210-001-18, Nr. 591-210-001-18, Nr. 620-210-001-18, Nr. 769-210-001-18, Nr. 286-210-001-18 në shumë prej 375.00 €, janë parashkruar sipas nenit 355 të LMD, pasi që propozimi i kreditorit për përmbartim është paraqitur me datë 19.03.2021, ndërsa për secilën nga kërkesat e kreditorit sipas faturave të cekura më lart kanë kaluar më tepër se 3 (tri) vite nga koha e maturimit / arritjes për pagesë, për këtë arsye vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Prandaj bazuar në të lartcekurat, Gjykata gjeti se kërkesa e kreditorit për faturat e lartcekura, pjesërisht nuk i plotësojnë kushtet e përcaktuara në LPP dhe pjesërisht janë parashkruar, andaj pjesërisht e aprovoi si të bazuar prapësimin e debitorit për shumën prej 891.80 €, e anuloi urdhrin për përmbartim P.nr.66/21 të datës 19.03.2021 të Përmbartuesit Privat Afet Mjeku, dhe vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Gjykata vendosi sikur në pikën II të dispozitivit të këtij aktvendimi, duke e lënë në fuqi Urdhrin e Përmbartuesit Privat P.nr.66/21 të datës 19.03.2021 për pjesën tjetër të detyrimit në shumën prej 10,195.60 €, dhe gjeti se i njëjti është i bazuar dhe nuk ka vjetërsim-parashkrim të borxhit të kreditorit në raport me debitorin për këtë periudhë kohore, referuar nenit 355 të Ligjit për Marrëdhëniet e Detyrimeve (Ligji Nr.04/L-077), në të cilën parashihet afati 3 (tre) vjeçar i parashkrimit për kërkesat reciproke nga kontratat komerciale si dhe kërkesat e shpërblimit të shpenzimeve lidhur me këto kontrata, ndërsa parashkrimi rrjedh veç e veç për çdo dërgim të mallit, pune ose shërbimi të kryer, edhe për faktin se pjesa tjetër e dokumenteve të besueshme – faturat në bazë të cilave është iniciuar propozimi për përmbartim, i përmbajnë të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 të LPP-së.

Nisur nga fakti se në rastin konkret gjykata ka aprovuar pjesërisht prapësimin e debitorit duke u bazuar në nenin 12 paragrafin 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore, me të cilin përcaktohet se: *“Në rast se e aprovon prapësimin, gjykata varësisht nga rrethanat e rastit e përfundon përmbartimin në tërësi ose pjesërisht dhe i anulon veprimet e kryera”*, Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit, dhe e përfundoi pjesërisht procedurën e përmbartimit.

Gjykata në kuptim të nenit 71 dhe 73 të LPP-së, nenit 12 par. 2 të Ligjit Nr. 05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe nenit 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Parë – Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.1007/22, datë 14.11.2023

Gjyqtari

Gent Bekeri

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.